

VENDIM
Nr. 209, datë 27.9.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË AEE SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “PLUG”, ME FUQI
TË INSTALUAR 2 mw, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË LUSHNJË, QARKU
FIER**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”; të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 15, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 27.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë AEE sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Plug”, me fuqi të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Bashkinë Lushnjë, qarku Fier,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 191, datë 30.8.2018, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë AEE sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Plug”, me fuqi të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Bashkinë Lushnjë, qarku Fier.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE me shkresën nr. 55/56 prot., datë 30.8.2018, ka bërë njoftimin në median e shkruar, si dhe me shkresën nr. 549/1 prot., datë 3.9.2018, ka përcjellë pranë subjektit njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës, si dhe mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 4.4.5, germa “a” (miratimin e OST-së ose OSHEE-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose të shpërndarjes).

- Shoqëria AEE sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 549/2 prot., datë 10.9.2018, ka plotësuar dokumentacionin e sipërcituar, duke përcjellë miratimin e OSHEE-së nr. 13870/1 prot., datë 2.6.2017, për pikën e lidhjes së centralit fotovoltaik.

- Aplikimi i shoqërisë AEE sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4 dhe 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Subjekti AEE sh.p.k. ka marrë miratimin përfundimtar nga MIE për një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër, ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet. Por, duke qenë se nga studimi i fizibilitetit të paraqitur nga subjekti për centralin fotovoltaik “Plug”, rezulton se jetëgjatësia e panelit shkon deri më 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit

maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë AEE sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Plug”, me fuqi të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Bashkinë Lushnjë, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar (njëzetepesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti